



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

Departamenti i Prokurimit / Departament za Javnu nabavku / Department of Procurement

DATË/A:	26.12.2012
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Sektorin e Shqyrtimit të Vendimeve në Doganën e Kosovës (adresa: Qyteza Pejton, Rr. "Mujo Ulqinaku" Prishtinë).
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ilhami Gashi – Sekretar i Përgjithshëm në MPB
NGA/OD/FROM:	Agim Islami – Ud Drejtor i Departamentit të Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Ankesë kundër Aktvendimit Nr. 04.3.2.861 të nxjerrë nga Dogana e Kosovës, me datën 13.12.2012

Te nderuar

Ministria e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme MPB-ja) më datën 13.12.2012, ka pranuar nga Dogana e Kosovës (Sektori i Auditimit të Jashtëm-Departamenti Përbushjes), Aktvendimin nr. 04.3.2/861 L.I.-KI/0151, datë 13.12.2012 për mes të cilit keni kërkuar nga MPB-ja të paguaj taksat doganore, tatimet dhe TVSH-në (gjithsej në vlerë 354,052.20 euro) në emër të importimit të Pasaporta Elektronike (Biometrike).

MPB-ja në kuadër të përgjegjësiive që i janë dhënë në legjislacionin përkatës, ka shqyrtuar me kujdes Aktvendimin nr. 04.3.2/861 L.I.-KI/0151, datë 13.12.2012 (në tekstin e mëtejme aktvendimin), Kontratën Nr. 214 10 099 112 për Furnizim me Pasaporta Elektronike (Biometrike) dhe legjislacionin përkatës që e rregullon çështjen e obligimeve doganore, përfshirë taksat dhe TVSH-në dhe nuk pajtohet me Aktvendimin e Doganës së Kosovës.

MPB-ja duke u bazuar në legjislacionin përkatës, me datën 17.06.2011 ka lidhur Kontratën Nr. 214 10 099 112 për Furnizim me Pasaporta Elektronike (në tekstin e mëtejshme Kontrata), me OESD-në (akronimi i Kontraktuesit), në të cilën kontratë janë përcaktuar shumë qartë të drejtat dhe obligimet e se cilës palë.

Në bazë të Kontratës MPB-ja është vetëm blerës e jo edhe importues i pasaportave elektronike, ashtu siç pretendon Dogana e Kosovës.

MPB-ja me rastin e pranimit të faturave për mallin e blerë i ka paguar kompanisë çmimin e secilës pasaportë duke përfshirë të gjitha taksat doganore, tatimet dhe TVSH-në.

Neni 3 paragrafi 3.1 i Kontratës përcakton shumë qartë se kompania OESD (në këtë rast OESD është shitësi) është e obliguar që të paguaj të gjitha taksat doganore, tatimet dhe TVSH-në kur merret parasysh së në këtë paragraf është e përcaktuar DDP-ja (Incoterms 2000). Sipas Incoterm-it DDP shitësi i mallrave ngarkohet me të gjitha taksat doganore, TVSH dhe të gjitha rreziqet e tjera të importit të mallit deri në vendosjen e mallit në deponë e blerësit.

Po ashtu nën 5 i pjesës së III-të të Kontratës ku janë paraparë kushtet e veçanta të kontratës, operatori ekonomik (OESD) ka qenë i obliguar të regjistrohet në Regjistrin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtar të Kosovës, brenda një afati të arsyeshëm kohor pas dhënies së Kontratës, me qëllim të kryerjes së obligimeve doganore, tatimeve dhe TVSH-së, që rrjedhin nga kontrata.

Prandaj duke u bazuar në dispozitat përkatëse të kontratës dhe dispozitat përkatëse të DDP-së, MPB nuk është e obliguar t'i kryej taksat doganore dhe TVSH-në, por këto obligime duhet të kryhen nga OESD-ja ose përfaqësuesi i autorizuar i OESD-së i regjistruar në Kosovë.

Shpresoj që Dogana e Kosovës të merr për bazë këtë ankesë dhe duke u bazuar në faktet dhe legjislacionin përkatës, të kërkoj kryerjen e taksave doganore, tatimeve dhe TVSH-së nga OESD-ja ose përfaqësuesi i autorizuar i OESD-së i regjistruar në Kosovë.

Me respekt,